



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Në mbështetje me nenin 47, paragrafi (1), pika 6) të Ligjit të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15, 6/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 110/21) dhe nenin 64 paragrafi (3) të Ligjit të Bankave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 67/07, 90/09, 67/10, 26/13, 15/15, 153/15, 190/16 dhe 7/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19 dhe 122/21), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, miratoi

VENDIM

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 27 / 24)

1. Në Vendimin për metodologjinë e përcaktimit të përshtatshmërisë së kapitalit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 47/12, 50/13, 71/14, 223/15, 218/16 dhe 221/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 181/19, 116/20 dhe 167/20), në pikën 7), pas fjalës: "Bankat", shtohen fjalët: "dhe me aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji".

2. Në pikën 70), paragrafi (1) ndryshohet dhe bëhet:

"Në kërkesat e mbuluara me hipotekë me objekt banimi, banka aplikon ponderim të rrezikut prej 35%, nëse kërkesa e mbuluar me hipotekë me objekt banimi i plotëson kriteret nga pika 71) paragrafi (1) të këtij vendimi."

3. Në pikën 71), paragrafi (1) nënparagrafet (4) dhe (5), ndryshohen dhe bëhen:

- "- banka është e detyruar të sigurojë vlerësim të vlerës tregtare aktuale të objektit të banimit në pajtim me paragrafet (2) dhe (3) të kësaj pike;
- banka posedon dokumentacionin e duhur për objektin e banimit të hipotekuar i cili përbëhet nga: akt noterial me shtojca për hipotekë të vendosur mbi objektin, përfshirë edhe klauzolë përmbarueshmërie, fletëpronësi ose deshmi tjetër nga libri publik për hipotekë të vendosur i lëshuar nga institucioni kompetent, polisë sigurimi të vlefshme për objektin e banimit të lidhur në favor të bankës dhe dokumentacion tjetër përkatës; dhe".

Pas paragrafit (1) shtohen dy paragrafe të reja (2) dhe (3) dhe bëhen:

"Gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës në bazë të së cilës ka ndodhur kërkesa e mbuluar me hipotekë të objektit të banimit, banka është e detyruar ta ndjek vlerën e tregut të objektit të banimit (p.sh. nëpërmjet aplikimit të metodave statistikore) dhe atë së paku një herë në vit dhe të sigurojë vlerësimin e

vlerës aktuale të tregut të objektit të banimit, së paku një herë në çdo tre vite, në pajtim me ligjin.

Me përjashtim të paragrafit (2) të kësaj pike, banka është e detyruar të sigurojë vlerësim të vlerës aktuale të tregut të objektit të banimit së paku një herë në vit, për kërkesën e cila:

- tejkalon 5% nga mjetet personale të bankës;
- është siguruar me hipotekë me objekt banimi tek i cili ka ndodhur rënie e konsiderueshme e vlerave të tregut të objekteve të ngjajshme të banimit, ose
- është siguruar me hipotekë me objekt banimi të pandërtuar për të cilin është lëshuar leje ndërtimi nga institucioni kompetent, përfshirë edhe tokën ndërtimore për të cilën është lëshuar leje ndërtimi nga institucioni kompetent, me ç'rast vlerësimi i vlerës së tregut duhet të pasqyrojë vlerën aktuale të sigurimit, në pajtim me fazën e ndërtimit në të cilën gjendet objekti i banimit."

4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

V. nr. 02-3972/XX-3/3
2 shkurt 2024
Shkup

Guvernatorja dhe kryesuesja
e Këshillit të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë së Veriut

д-р Анита Ангеловска-Бежоска

